

VENDIM
Nr. 347, datë 13.4.2023

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË “PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”, QARKU ELBASAN, Z. SHKËLQIM SHEFQET BULLARI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1073/1 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Besion Gëzim Ajazi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 416, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill 2021, ka fituar 8 (tetë) mandate.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 416, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 09 (nëntë), z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

Me shkresën nr. 2228 prot., datë 29.3.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në

përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me 16 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b”, dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Shkëlqim Shefqet Bullari, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Besion Gëzim Ajazi i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore Elbasan, i renditur me numër rendor 9 (nëntë), z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VENDOS:

1. Dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi